



BASHKIA KURBIN

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2025



Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	1
LISTA E TABELAVE	2
1. FJALOR SHPJEGUES.....	3
2. QËLLIMI I RAPORTIT.....	7
3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË	7
4. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË	8
5. SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE.....	9
5.1. Arsimi Parauniversitar	9
5.2. Menaxhimi i Mbetjeve	14
5.3. Mbrojtja nga zjarri	16
5.4. Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....	17
5.5. Administrimi i pyjeve dhe kullotave	19
5.6. Mbrojtja Sociale.....	20
5.7. Administrimi i tregjeve.....	24
6. SHËRBIMET E REJA.....	27
6.1. Rrjeti rrugor	27
6.2. Ndriçimi publik.....	28
6.3. Kultura.....	28
6.4. Sport dhe Argëtim.....	29
7. QEVERISJA E MIRË	30
7.1. Transparenca	30
7.2. Barazia Gjinore.....	32
7.3. Burimet njerëzore	34
7.4. Integrimi në BE	35
7.5. Menaxhimi financiar	37
8. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	41
8.1. Konkluzione	41
8.2. Rekomandime kryesore.....	42

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Të dhënat e detajuara për arsimin parauniversitar.....	10
Tabela 2: Të dhënat në burim për arsimin parauniversitar	12
Tabela 3: Të dhënat e detajuara për menaxhimin e mbetjeve	14
Tabela 4: Të dhënat në burim për menaxhimin e mbetjeve.....	15
Tabela 5: Të dhënat e detajuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri.....	17
Tabela 6: Të dhënat në burim për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri	17
Tabela 7: Të dhënat e detajuara për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	18
Tabela 8: Të dhënat në burim për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	19
Tabela 9: Të dhënat në burim për administrimin e pyjeve dhe kullotave	20
Tabela 10: Të dhënat e detajuara për mbrojtjen sociale.....	21
Tabela 11: Të dhënat në burim për mbrojtjen sociale	23
Tabela 12: Të dhënat e detajuara për rrjetin rrugor	28
Tabela 13: Të dhënat e detajuara për ndriçimin publik.....	28
Tabela 14: Të dhënat e detajuara për kulturën	29
Tabela 15: Të dhënat e detajuara për sportin dhe argëtimin	29
Tabela 16: Të dhënat e detajuara për transparencën	31
Tabela 17: Të dhënat në burim për transparencën.....	31
Tabela 18: Të dhënat e detajuara për barazinë gjinore.....	33
Tabela 19: Të dhënat në burim për barazinë gjinore	33
Tabela 20: Të dhënat në burim për burimet njerëzore	35
Tabela 21: Të dhënat e detajuara për koordinimin e integritit evropian	36
Tabela 22: Të dhënat në burim për koordinimin e integritit evropian	37
Tabela 23: Të dhënat e detajuara për menaxhimin financiar	39
Tabela 24: Të dhënat në burim për menaxhimin financiar.....	40
Tabela 25: Të dhënat e detajuara për administrimin e tregjeve.....	25
Tabela 26: Të dhënat në burim për administrimin e tregjeve	26

1. FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të vënë në pah pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të orientuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mirë materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile, etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish

të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Shërbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Këto përfshijnë, ndër të tjera, ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit të ligjit “janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë.

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak.

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe atë publik dhe

organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia.

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që buxheti i shtetit i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara bashkisë.

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që buxheti shtetit i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që buxheti i shtetit i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë me ligj të veçantë.

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korrent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Pavarësisht nga kjo, ato mund të përdoren gjatë vitit korrent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetorë specifikë për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në çdo fushë paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. “Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara”).
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2024} - \text{Vlera 2023}) / \text{Vlera 2023} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2024 – Vlera 2023). Simboli I Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet

Në tabelat e performancës, trendi llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm “vlera pozitive ndryshimi = trend rritës”. Ky rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë “përkeqësim” edhe në raste kur rezultati real është pozitiv, kjo sepse për disa tregues ulja e vlerës absolute tregon përmirësim të performancës, siç janë psh. detyrimet e prapambetura, shpenzimet administrative, etj.

2. QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 20 fusha funksionale për vitet 2024-2025 në fushat si vijon : arsimi parauniversitar, menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja sociale, rrjeti rrugor, transporti publik, ndriçimi publik, gjelbërimi i sipërfaqeve publike, mirëmbajtja e varrezave, shërbimi i kulturës, sportet, transparenca, burimet njerëzore, barazia gjinore, integrimi në BE, menaxhimi financiar, administrimi i tregjeve dhe mbështetja e biznesit. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Kurbin me asistencën e projektit “Bashki të Forta” dhe i miratuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Kurbin shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në zonën midis lumenjve Mat në veri dhe Droje në jug. Nga Veriu kufizohet me Bashkinë e Lezhës dhe të Mirditës, në Lindje me Bashkinë Mat, në Jug me Bashkinë e Krujës dhe të Durrësit dhe në Perëndim me Detin Adriatik. Bashkia Kurbin ka një sipërfaqe prej 271 km² dhe popullsi prej 75696 banorësh (sipas regjistrit të gjendjes civile për vitin 2025). Përbëhet nga 4 njësi administrative: Laç, Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, ku Laçi është njësi qendër e bashkisë.

Misioni i Bashkisë Kurbin është mirëqeverisja dhe administrimi i gjithë territorit nën juridiksionin e saj, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve, të realizojë dhe të ofrojë shërbime cilësore, efçente dhe efikase për komunitetin lokal, duke respektuar identitetin dhe vlerat e saj.

Për përmbushjen e qëllimit të saj bashkia ka si objektiva kryesorë : zhvillimin ekonomik vendor, përmirësimin e infrastrukturës së godinave arsimore për të ofruar një shërbim më cilësor për nxënësit edhe të rinjtë, ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale për target grupet vulnerabël, përmirësimin e infrastrukturës së kanaleve kulluese dhe vaditëse për tokat bujqësore në mënyrë që të nxitet zhvillimi i bujqësisë, mbrojtjen dhe përshtatjen për parandalimin e situatave të fatkeqësive natyrore, mbrojtjen e mjedisit, mbulimin e gjithë territorit të bashkisë me shërbimin e pastrimit të mbetjeve, rritjen e kapaciteteve të bashkisë për përthithjen e fondeve, granteve, dhe instrumenteve të tjera të ndihmës financiare kombëtare ose ndërkombëtare, përmirësimi i infrastrukturës rrugore, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra publike.

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit lidhen me: ndryshimet demografike, zhvillimin e planeve të ndryshme sektoriale dhe zbatimin e tyre, forcimin e kapaciteteve financiare që lidhen me të ardhurat e veta, ofrimin e shërbimeve të specializuara sociale në qendrat ditore për grupet vulnerabël, rritja e numrit të trajnimeve për stafin e bashkisë, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, rritja e ndërveprimit komunitet-vendimmarrës-bashki.

4. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2025
Popullsia totale në administrimin e bashkisë	75696
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	271 km ²
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	12409 ha
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	10324 ha
Numri total i njësive administrative të bashkisë	4
Numri i fshatrave	27
Punonjës të bashkisë në total	607
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	242
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	365
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	199

5. SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësive të saj sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Në këtë seksion janë trajtuar 6 funksione: arsimit parauniversitar (duke përfshirë çerdhet, arsimin parashkollor dhe infrastrukturën e godinave arsimore), menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe kullotave dhe mbrojtja sociale.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtare, tregues të tjerë vendorë që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë arritjet, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

5.1. ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimit parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”
- Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkia është përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e saj.

Në këtë seksion janë monitoruar tregues kryesorë dhe nën-tregues, të cilët mbulojnë qasjen në arsim (regjistrimin në çerdhe dhe kopshte publike e private), cilësinë e shërbimit (raportin fëmijë-mësues) si dhe gjendjen e infrastrukturës arsimore.

Gjatë vitit 2025 vihet re një rritje e lehtë e kapaciteteve dhe pjesëmarrjes në arsimin e hershëm, ku numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhet publike është rritur nga 110 në 118 fëmijë, duke shënuar një rritje prej 8 fëmijësh. Ndërkohë, edhe pjesëmarrja në kopshtet publike për grupmoshën 3–6 vjeç ka shënuar një rritje modeste, duke kaluar nga 1025 fëmijë në 1041 fëmijë. Stafit i edukatoreve në çerdhe publike reflektohet i njëjtë nga viti 2024 në vitin 2025, por vihet re përmirësimi i kapaciteteve sa i përket stafit mbështetës në arsimin bazë dhe atë të mesëm pasi gjatë vitit 2025 janë realizuar trajnime dhe thuajse 70% e stafit është i trajnuar për sa i përket arsimit parashkollor.

Sa i përket burimeve njerëzore, numri i edukatorëve në kopshtet publike mbetet i pandryshuar, konkretisht në 78 për vitin 2025. Struktura institucionale parauniversitare ka qëndruar e njëjtë: bashkia vazhdon të ketë 1 çerdhe publike dhe asnjë çerdhe private, 21 kopshte publike dhe asnjë privat, si edhe 22 shkolla 9-vjeçare publike e asnjë private. Edhe në arsimin e mesëm të përgjithshëm, situata mbetet e pandryshuar me 4 shkolla të mesme publike, ndërsa për shkollën e mesme private reflektohet me zero për vitin 2025. Sa i përket infrastrukturës fizike arsimore, situata paraqitet pozitive pasi një pjesë e mirë e tyre janë të rindërtuara apo të rikonstruktura që në periudhën post-tërmetit 2019, duke ofruar kushte më të mira për mësimdhënien. Në aspektin e planifikimit strategjik, Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar është hartuar dhe miratuar duke reflektuar progres në këtë drejtim për vitin e raportimit.

Tabela 1: Të dhënat e detajuara për arsimin parauniversitar

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Çerdhe të mirëmbajtura kundrejt numrit total të çerdheve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Kopshteve të mirëmbajtura kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare	nxënës/mësues	9.27	8.64	-0.63	↓	-6.80%

Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike	nxënës/klasë	16.72	16.30	-0.42	↓	-2.50%
Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik	nxënës/klasë	15.07	15.31	0.24	↑	1.56%
Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare	punonjës mbështetës/shkollë 9 vjeçare	1.77	2.64	0.86	↑	48.72%
Shkolla 9 vjeçare të rikonstruktura	numër	9.00	4.00	-5.00	↓	- 55.56%
Kopshte të rikonstruktura	numër	1.00	0.00	-1.00	↓	- 100.00 %
Raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve (Mijë Lekë/institucion)	Mijë Lekë/institucion	437.23	677.88	240.65	↑	55.04%
Kopshte ku janë ngritur këshillat e prinderve kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Punonjës mbështetës për shkollë mesme të përgjithshme	punonjës mbështetës/shkollë e mesme	5.00	7.50	2.50	↑	50.00%
Numri mesatar i nxënësve në një klasë të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik	nxënës/klasë	26.26	27.86	1.60	↑	6.10%
Raporti i personelit të trajnuar kundrejt numrit total të personelit në çerdhe (në %)	%	35.00	70.00	35.00	↑	100.00 %
Raporti i çerdheve të furnizuara me material didaktik kundrejt numrit total të çerdheve (në %)	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%
Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	13.14	13.35	0.21	↑	1.56%

Tabela 2: Të dhënat në burim për arsimin parauniversitar

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D01	Numri I çerdheve publike të mirëmbajtuara	1	1	1	Numër
D02	Numri I kopshteve publike të mirëmbajtuara	-	21	21	Numër
D03	Numri I shkollave 9 vjeçare publike të mirëmbajtuara	-	22	22	Numër
D04	Numri I nxënësve të regjistruar në shkolla 9 vjeçare publike	-	3829	3603	Numër
D05	Numri I mësuesve që japin mësim në shkolla 9 vjeçare publike	-	413	417	Numër
D06	Numri I klasave të kopshteve publike	-	68	68	Numër
D07	Numri I klasave të shkollave 9 vjeçare publike	-	229	221	Numër
D08	Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë të rikonstruktura	4	9	4	Numër
D09	Numri i ndërtesave publike të arsimit parashkollor të rikonstruktura	5	1	0	Numër
D10	Numri i stafit mbështetës në arsimin bazë në shkollat 9 vjeçare publike	-	39	58	Numër
D11	Shpenzime për institucione publike të arsimit parauniversitar: çerdhe, kopshte, shkolla 9 vjeçare, shkolla të mesme të përgjithshme	-	20987	32538	Mijë Lekë
D12	Numri i kopshteve publike ku janë ngritur këshillat e prindërve	-	21	21	Numër

D13	Numri i stafit mbështetës në shkolla të mesme të përgjithshme publike	-	20	30	Numër
D16	Numri i nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme të përgjithshme publike	-	998	1031	Numër
D17	Numri i klasave në shkolla të mesme të përgjithshme publike	-	38	37	Numër
D22	Numri i personelit të çerdheve publike	-	20	20	Numër
D23	Numri i personelit të trajnuar të çerdheve publike	-	7	14	Numër
D24	Numri i çerdheve publike të furnizuara me material didaktik	1	1	1	Numër
D26	Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	90	110	118	Numër
D28	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	1074	1025	1041	Numër
D30	Numri i edukatorëve në kopshte publike	74	78	78	Numër
D32	Numri i çerdheve publike në bashki	1	1	1	Numër
D34	Numri i kopshteve publike në bashki	21	21	21	Numër
D36	Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	22	22	22	Numër
D38	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	4	4	4	Numër
D39	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	1	1	0	Numër
D40	Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	0	0	1	Po/Jo

5.2. MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e e pastërtisë në hapësirave publike si: rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion është e përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike. Në vitin 2025, performanca e bashkisë në menaxhimin e mbetjeve paraqitet e qëndrueshme. Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve mbetet në të njëjtën vlerë si një vit më parë (72.22%), si në total ashtu edhe i detajuar sipas zonave urbane (100.00) dhe rurale (44.00), duke treguar një shtrirje të konsoliduar të shërbimit në territor. Mbetjet e gjeneruara të matshme në kg/banor kanë shënuar një rënie të lehtë nga 18 në 15 kg/banor (-12%). Një zhvillim pozitiv është rritja e të ardhurave nga tarifa e shërbimit, ç’ka tregon një lëvizje graduale drejt qëndrueshmërisë financiare të sistemit. Bashkia ka Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve 2020-2025, i cili vijon të jetë në fuqi dhe ofron një kornizë të qëndrueshme strategjike për organizimin dhe përmirësimin e shërbimit. Në tërësi rritja e mbulimit të kostove dhe ekzistencës së planit tregon një bazë solide mbi të cilën bashkia mund të vazhdojë të forcojë cilësinë dhe efikasitetin e menaxhimit të mbetjeve.

Tabela 3: Të dhënat e detajuara për menaxhimin e mbetjeve

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	72.22	72.22	0.00	→	0.00%

Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	0.18	0.15	-0.02	↓	- 12.15%
Mbulimi kosos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	137.44	113.16	-24.28	↓	- 17.67%
Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%
Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	44.44	44.44	0.00	→	0.00%

Tabela 4: Të dhënat në burim për menaxhimin e mbetjeve

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D54	Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	3	3	3	Numër
D55	Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	3	3	3	Numër
D56	Numri fshatrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	12	12	12	Numër
D57	Numri fshatrave në territorin e bashkise	27	27	27	Numër
D58	Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	12240	13245	11653	Ton
D59	Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	8128	9889	12606	mijë Lekë
D60	Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	0	7195	11140	mijë Lekë

D61	Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	75339	75582	75696	Numër

5.3. MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë: Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.

Gjatë periudhës 2025, performanca e bashkisë në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave civile ka mbetur e pandryshuar. Treguesi “Zjarrfikës për 1,500 banorë” është po i njëjtë nga 0.40 në 0.40 punonjës për 1,500 banorë, që përfaqëson të njëjtin numër të kapaciteteve operacionale të shërbimit zjarrëfikës e disponueshmërisë së personelit për reagim ndaj emergjencave. Shërbimi zjarrëfikës i Bashkisë mbetet i angazhuar për të garantuar siguri më të lartë për komunitetin dhe për të përmbushur standardet e nevojshme të mbrojtjes civile.

Nga ana tjetër, treguesi “Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë” ka mbetur i pandryshuar në 0.40 mjete për 10,000 banorë, duke treguar mungesë investimesh të reja në pajisje dhe mjete zjarrëfikëse gjatë periudhës së raportimit. Edhe pse ky tregues nuk ka pësuar rënie numerike, ruajtja e së njëjtës flotë mjetesh në raport me popullsinë sugjeron nevojën për modernizim dhe shtim të kapaciteteve teknike, sidomos në zonat me rrezik të lartë zjarri.

Tabela 5: Të dhënat e detajuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.40	0.40	0.00	↓	-0.15%
Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.40	0.40	0.00	↓	-0.15%

Tabela 6: Të dhënat në burim për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D51	Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	17	20	20	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	75339	75582	75696	Numër
D53	Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	3	3	3	Numër
D50	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	4	9	9	Numër

5.4. MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funkzioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Gjatë periudhës 2025, sektori i ujitjes dhe kullimit ka shënuar përmirësim, veçanërisht në aspektin e funksionalitetit të kanaleve, ndërkohë që treguesi i mbulimit të tokës bujqësore ka mbetur i pandryshuar. Treguesi “Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi” ka ruajtur të njëjtën vlerë prej 70%, duke treguar se sipërfaqja e tokës me infrastrukturë hidrike të instaluar ka mbetur konstante. Megjithatë, përmirësimet janë të dukshme në cilësinë dhe funksionalitetin e rrjetit ekzistues.

Në mënyrë të veçantë, “Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale” është rritur nga 91.85% në 95.15%, që përfaqëson një rritje prej 3.6%, duke sinjalizuar përmirësime në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemit ekzistues. Kjo tendencë pozitive reflektohet edhe në nëntreguesit: “Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale”, i cili është rritur nga 83.70% në 90.31% (rritje prej 7.89%), ndërsa “Përqindja e kanaleve kulluese funksionale” është e pandryshuar si tregues për arsye se të gjitha kanalet kulluese ekzistuese që janë në administrim e bashkisë kryejnë funksionin e kullimit të tokave bujqësore.

Mbetet sfiduese situata me kanalet e I-ra të kullimit të cilat janë nën administrimin e Bordit Rajonal Lezhë. Gjithashtu indikator i “tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/ kullimi” mbetet sfidues pasi reflektohet që jo çdo sipërfaqe mbulohet me këtë rrjet. Kjo shpesh ndodh pasi kanalet janë asgjësuar nga vetë banorët duke kryer veprime të palejuara.

Megjithatë rezultatet tregojnë një progres të qëndrueshëm në menaxhimin dhe efikasitetin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, që mund të lidhet me ndërhyrje të qëllimshme të bashkisë në pastrimit të kanaleve, riparimin e segmenteve të dëmtuara dhe mirëmbajtjen periodike të infrastrukturës ekzistuese.

Tabela 7: Të dhënat e detajuara për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	70.00	70.00	0.00	↓	-0.01%
Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	91.85	95.15	3.30	↑	3.60%
Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	83.70	90.31	6.61	↑	7.89%
Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%

Tabela 8: Të dhënat në burim për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D41	Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	10392	10392	10392	Hektarë
D42	Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	7274.4	7274.4	7274	Hektarë
D43	Gjatësia e kanaleve ujitëse	454	454	454	Kilometër
D44	Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	360	380	410	Kilometër
D45	Gjatësia e kanaleve kulluese	506.5	506.5	506.5	Kilometër
D46	Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	506.5	506.5	506.5	Kilometër

5.5. ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm: Funkzioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Gjatë periudhës 2024–2025, performanca në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave ka qenë e qëndrueshme në aspektin e planifikimit strategjik, si dhe në aspektin e kapaciteteve njerëzore të administrimit. Bashkia nuk ka hartuar apo miratuar ende një plan menaxhimi për fondin pyjor dhe kullor gjatë kësaj periudhe. Kjo nënkupton mungesën e një kuadri të strukturuar për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke theksuar nevojën për ndërhyrje në drejtim të planifikimit dhe koordinimit të politikave mjedisore. Sa i përket treguesit “Punonjës për 1,000 hektarë”, ka mbetur i njëjtë rezultati me vitin e mëparshëm, duke paraqitur të njëjtat kapacitete njerëzore dhe të mbikëqyrjes mbi fondin pyjor dhe kullor.

Në përgjithësi, të dhënat e vitit 2025 tregojnë që aspekti i planifikimit strategjik mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së planit vendor të mbarështimit. Për të garantuar një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, rekomandohet që bashkia të finalizojë dhe zbatojë një plan

të integruar mbarështimi, që të lidhë rritjen e kapaciteteve njerëzore me objektiva konkrete për ruajtjen dhe zhvillimin e burimeve natyrore.

Tabela 9: Të dhënat në burim për administrimin e pyjeve dhe kullotave

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D47	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	0	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D48	Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullor në bashki	12409	12409	12409	Hektarë
D50	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor	4	9	9	Numër

5.6. MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me organizata jo fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Gjatë periudhës 2025, performanca e bashkisë në fushën e shërbimeve dhe mbrojtjes sociale ka shënuar përmirësime në disa tregues, duke reflektuar një rritje të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve ndaj grupeve në nevojë dhe forcimin e mekanizmave të bashkërendimit institucional. Një nga treguesit më domethënës është “Shkalla e miratimit të strehimit social”, e cila ka pësuar një rritje të ndjeshme nga 65.59% në 71.88%, me një ndryshim pozitiv prej 9.58 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar. Ky progres tregon një angazhim të shtuar të bashkisë në trajtimin e nevojave për strehim të shtresave vulnerabël dhe në zbatimin e programeve sociale efektive. Gjithashtu, “Numri i qendrave sociale komunitare publike të licencuara për 10,000 banorë” është rritur nga 0.40 në 0.79, duke treguar zgjerimin e infrastrukturës institucionale për ofrimin e

shërbimeve sociale në nivel lokal. Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të aksesit të qytetarëve në shërbime të specializuara sociale dhe komunitare.

Sa i përket treguesit “Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (MKR) që përfitojnë shërbime sociale”, paraqitet e qëndrueshme, duke treguar efikasitet të lartë në bashkërendimin ndërinstitutional dhe në ndjekjen e rasteve sociale deri në ofrimin e shërbimeve konkrete. Treguesi “Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike” paraqitet në rritje pasi për vitin e raportimit kemi rritje të aplikimeve në skemën e ndihmës ekonomike. Sa i përket përfituesve është në rritje numri i tyre nga viti 2024 në viti 2025, por sa i përket raportit të numrit të familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike kundrejt numrit total të aplikimeve, shohim se 40.4% e tyre janë përfitues. Ndërkohë, bashkia ka hartuar dhe vazhdon të zbatojë Planin Vendor Social gjatë periudhës së raportimit, duke siguruar vazhdimësi në politikat dhe masat për mbrojtjen e shtresave në nevojë. Në përmbledhje, të dhënat e vitit 2025 reflektojnë qëndrueshmëri të kapaciteteve institucionale në ofrimin e shërbimeve sociale.

Tabela 10: Të dhënat e detajuara për mbrojtjen sociale

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trend i	Simbol	% Ndrysimi
Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	36.00	40.43	4.43	↑	12.29 %
Shkalla e miratimit të strehimit social	%	65.59	71.88	6.28	↑	9.58%
Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banorë	0.40	0.79	0.40	↑	99.70 %
Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga komisionet biopsiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	17.18	47.71	30.53	↑	1.78%

Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%
Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Përqindja e rasteve grupmosha 0-17 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Përqindja e rasteve grupmosha 18-29 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	33.33	- 66.67	↓	- 66.67 %
Përqindja e rasteve grupmosha 30-44 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%
Përqindja e rasteve grupmosha 45-59 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00			↑	
Përqindja e rasteve grupmosha 60+ vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%		50.00		↓	
Përqindja e femrave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	14.01	53.60	39.59	↑	2.83%

Përqindja e meshkujve me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	0.00	0.00	0.00		0.00%
Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	52.21	49.33	-2.87	↓	-5.50%
Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	13.08	47.27	34.19	↑	2.61%

Tabela 11: Të dhënat në burim për mbrojtjen sociale

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D62	Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	480	500	470	Numër
D63	Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	140	180	190	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	75339	75582	75696	Numër
D64	Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	64	93	96	Numër
D65	Numri i personave përfitues të strehimit social	12	61	69	Numër
D66	Numri i qendrave sociale ditore funksionale	1	2	5	Numër
D67	Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	1	1	1	Numër

D68	Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	21	15	22	Numër
D69	Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	10	15	22	Numër
D70	Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale		1298	700	Numër
D71	Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit		223	334	Numër
D72	Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1	1	1	Cilesore(P o=1/Jo=0)

5.7. ADMINISTRIMI I TREGJEVE

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 28 thekson një funksion tjetër të bashkive lidhur me zhvillimin ekonomik që është ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë, si dhe organizimin e shërbimeve, menaxhimin dhe kontrollin e të gjitha tregjeve publike në territorin e bashkisë, si tregjet ushqimore, fruta-perime, gjësë së gjallë, industriale dhe tregjet sezonale , të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik vendor.

Gjatë vitit 2025, administrimi i tregjeve në bashki paraqitet i qëndrueshëm dhe funksional, duke reflektuar një menaxhim të konsoliduar të kapaciteteve ekzistuese dhe garantim të vazhdueshëm të shërbimeve për komunitetin. Treguesit kryesorë të infrastrukturës dëshmojnë stabilitet të plotë, ku numri i tregjeve bujqësore publike, sipërfaqja e tyre dhe kapacitetet tregtare (tezgat) kanë mbetur të pandryshuara. Ky qëndrueshmëri tregon mirëmbajtje efektive dhe përdorim të qëndrueshëm të aseteve ekzistuese, duke siguruar vijimësinë e shërbimeve për tregtarët dhe qytetarët. Në aspektin cilësor, përqindja e tregjeve me infrastrukturë të plotë mbetet në nivel të ulët (33%), çka nënkupton se vetëm një pjesë e kufizuar e tregjeve ofron kushte të përshtatshme për tregtarët dhe konsumatorët. Ky tregues i pandryshuar sinjalizon nevojën për ndërhyrje në përmirësimin e kushteve bazë si uji, energjia, kanalizimet dhe shërbimet higjieno-sanitare. Nga analiza e të dhënave burimore, vihet re një rritje e numrit të vendeve të zëna në tregje (nga 86 në 90), që tregon një rritje të lehtë të përdorimit të kapaciteteve ekzistuese. Kjo mund të interpretohet si një shenjë pozitive e kërkesës për tregtim, pavarësisht mungesës së investimeve të reja.

Në përfundim, administrimi i tregjeve në vitin 2025 karakterizohet nga stabilitet në aspektin strukturor, por me mungesë zhvillimi dhe përmirësimi cilësor. Për të përmirësuar performancën, kërkohet fokus në rritjen e investimeve, përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe nxitjen e aktiviteteve që gjallërojnë jetën ekonomike të tregjeve.

Tabela 12: Të dhënat e detajuara për administrimin e tregjeve

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Trend Symbol	% Ndryshimi
Numri total i tregjeve publike bujqesore	Numër	3.00	3.00	0.00	→	0.00
Sipërfaqja mesatare për treg publik bujqesor	m ² / treg	1166.67	1166.67	0.00	→	0.00
Sipërfaqja totale e tregjeve publike bujqesore	m ²	3500.00	3500.00	0.00	→	0.00
Përqindja e tregjeve bujqesore me infrastrukturë të plotë	%	33.33	33.33	0.00	→	0.00
Numri i pikave të shitjes (tezgave) ne tregje bujqesore	Numër	130.00	130.00	0.00	→	0.00
Numri i eventeve “treg i fermerëve” / panairove ne tregje bujqesore	nr. / vit	2.00	1.00	-1.00	↓	-0.50
Numri i tregjeve të gjësë së gjallë funksionale	Numër	2.00	2.00	0.00	→	0.00
Frekuenca e organizimit të tregjeve të gjësë së gjallë	Ditë	48.00	48.00	0.00	→	0.00

Mbulimi e tregjeve me kontroll veterinar	%	50.00	50.00	0.00	→	0.00
Intensitetit i kontrolleve veterinare të kryera	Kontrolle / ditë tregu	0.63	0.63	0.00	→	0.00

Tabela 13: Të dhënat në burim për administrimin e tregjeve

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
EDT01	Numri total i tregjeve bujqesore publike në territor	3	3	3	Numër
EDT02	Sipërfaqja totale e tregjeve bujqesore ne m ²	3500	3500	3500	m ²
EDT03	Numri i pikave të shitjes (tezga) në tregje bujqesore ne total	130	130	130	Numër
EDT04	Numri i vendeve të zëna në tregjet bujqesore (shumatorja per te gjitha tregjet)	60	86	90	Numër
EDT08	Numri i tregjeve bujqesore me infrastrukturë të plotë (ujë, drita, kanalizim, ËC)	1	1	1	Numër
EDT11	Numri i eventeve të tipit “treg i fermerëve” / “panair lokal” ne tregje bujqesore	1	2	1	Numër
DGJ01	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë funksionale	2	2	2	Numër
DGJ02	Numri i ditëve të organizimit të tregut në vit	48	48	48	Ditë

DGJ04	Ekzistenca e kontrollit veterinar në tregjet e gjësë së gjallë	1	1	1	Po / Jo
DGJ05	Numri i kontrolleve veterinarë të kryera në vit		30	30	

6. SHËRBIMET E REJA

Bashkitë ushtrojnë edhe funksione të tjera bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ku janë përgjegjëse për të kryer shërbimet e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale, për të kryer klasifikimin e rrjetit rrugor, krijimin e hartave të rrugëve dhe kadastrës së rrjetit rrugor në administrimin e bashkisë, dhënien e autorizimit, lejet për ndërtimin dhe mbrojtjen e rrugëve dhe hapsirave publike, instalimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit e sinjalistikës rrugore. Gjithashtu në bazë të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, bashkia është përgjegjëse për ndriçimin e mjediseve publike, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e trotuareve dhe shesheve publike vendore, garantimin e shërbimit të varrimit, administrimin e parqeve, lulishteve dhe hapsirave të gjelbërta publike, si dhe garantimin e shërbimit të transportit publik vendor. Po ashtu sipas nenit 25 të këtij ligji bashkia është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal si dhe organizimin e aktiviteteve sportive e argëtuese.

Për vitin e raportimit janë shtuar edhe 7 shërbime të reja në analizën e raportit të performancës si: rrjeti rrugor, transporti publik, sipërfaqet e gjelbra, ndriçimi publik, mirëmbajtja e varrezave, kultura, sport & argëtim. Për nga natyra e disa prej këtyre shërbimeve, bëhet e vështirë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, çfarë pasqyron mungesë të dhënash dhe kufizon vlerësimin e performancës së këtyre shërbimeve për vitin e raportimit.

6.1. RRJETI RRUGOR

Evidentohet një ulje e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor në periudhën 2024–2025, ç’ka sugjeron një reduktim të investimeve në këtë sektor. Në të njëjtën kohë, ngelet sfiduese mungesa e të dhënave mbi gjatësinë e rrjetit të shtruar, sinjalistikën dhe popullsinë e mbuluar, dhe kjo tregon domosdoshmëri për përmirësim e sistemit të raportimit.

Tabela 14: Të dhënat e detajuara për rrjetin rrugor

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Shpenzime për rrjetin rrugor	0.00	13340300.00	12758700.00	Mijë lekë

6.2. NDRIÇIMI PUBLIK

Shërbimi i ndriçimit publik paraqet një ulje të ndjeshme të shpenzimeve, ndërsa të ardhurat nga tarifa e ndriçimit kanë shënuar një rritje të lehtë. Kjo mund të interpretohet si përmirësim i eficiencës financiare. Megjithatë, mungesa e të dhënave mbi mbulimin me ndriçim dhe numrin e pikave funksionale kufizon analizën e plotë të cilësisë së shërbimit.

Tabela 15: Të dhënat e detajuara për ndriçimin publik

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Shpenzime për shërbimin e ndriçimit	0.00	20467886.00	23878394.00	Lekë
Të ardhura nga taksa e ndriçimit	1533000.00	2001912.00	2028000.00	Lekë

6.3. KULTURA

Spektori i kulturës paraqet zhvillime pozitive në aspektin e organizimit të aktiviteteve, të cilat promovojnë identitetin lokal dhe atë kombëtar. Gjithashtu, shpenzimet për kulturë janë në rritje, ndërsa të ardhurat nga aktivitetet janë shumë të ulëta, duke nxjerrë në pah një potencial të pashfrytëzuar për gjenerim të të ardhurave.

Tabela 16: Të dhënat e detajuara për kulturën

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Shpenzime totale për kulturë	0.00	10917940.00	13177108.00	Mijë Lekë
Të ardhura nga aktivitetet	0.00	0.00	60.00	Mijë Lekë

6.4. SPORT DHE ARGËTIM

Infrastruktura sportive rezulton funksionale dhe me rritje të këtyre hapësirave . Nga të dhënat e raportuara shohim se shpenzimet kanë shënuar një rritje të konsiderueshme në vitin 2025 në sektorin e sportit , investime që lidhen me mbështetjen që bashkia jep për klubin e futbollit K.F. Laçi, por edhe për terrenet sportive në shkolla të cilat janë konsideruar prioritet në vitin e raportimit.

Tabela 17: Të dhënat e detajuara për sportin dhe argëtimin

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Objekte sportive totale	0.00	15.00	18.00	Numër
Shpenzime totale për sport	0.00	34836017.00	41184731.00	Mijë Lekë

7. QEVERISJA E MIRË

7.1. TRANSPARENCA

Përshkrim i përgjithshëm : Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkia ka detyrimin të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japi llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin. Në këtë kuadër, bashkia duhet të garantojë: (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me ndikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ; (iii) hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit për të forcuar etikën institucionale.

Gjatë periudhës 2025, performanca e bashkisë në fushën e transparencës dhe qeverisjes së hapur ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm. Të dhënat tregojnë se angazhimi institucional për raportimin e transparencës është mbajtur në nivele të kënaqshme, ndërsa në fushën e konsultimeve publike është vërejtur një rënie e lehtë që sugjeron nevojën për forcim të mëtejshëm të proceseve pjesëmarrëse. Në veçanti, treguesi “Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik” ka pësuar rritje nga 80% në 100%.

Nga ana tjetër, treguesi “Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes” ka ruajtur vlerën për të dy vitet, duke treguar se bashkia ka hartuar dhe publikuar raportin vjetor, duke garantuar vazhdimësi në praktikën e raportimit dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore për transparencën institucionale. Ky është një element pozitiv që reflekton angazhim të qëndrueshëm për llogaridhënie dhe komunikim me publikun. Ndërkohë, treguesi cilësor “Plani Vendor i Integritetit” është realizuar, ç’ka tregon se bashkia e ka hartuar dhe miratuar këtë dokument strategjik, e cila drejton një sistem të plotë të parandalimit të korrupsionit dhe të promovimit të etikës në administratën publike vendore.

Në përmbledhje, të dhënat për vitin 2025 tregojnë një vazhdimësi të praktikave të raportimit transparent, përfshirjen qytetare përmes konsultimeve publike dhe forcimin e integritetit institucional. Këto elemente janë thelbësore për të garantuar një qeverisje më të hapur, të përgjegjshme dhe të ndershme në nivel vendor.

Tabela 18: Të dhënat e detajuara për transparencën

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	80.00	100.00	20.00	↑	25.00 %
Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%
Plani Vendor i Integritetit	Cilësore (Po=1/Jo=0)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%

Tabela 19: Të dhënat në burim për transparencën

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D77	Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	2	5	4	Numër
D78	Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	2	4	4	Numër
D79	Publikimi i raportit vjetor për transparencën	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D80	Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	0	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në përputhje me legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore, në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; buxhetim të përgjegjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione vendimmarrëse, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Të dhënat për periudhën 2025 tregojnë se niveli i barazisë gjinore në strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse të bashkisë ka mbetur përgjithësisht i qëndrueshëm. Konkretisht, treguesi “Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore” ka mbetur i pandryshuar në 29.73% për të dy vitet. Kjo përqindje, megjithëse përbën një nivel të pranueshëm të pjesëmarrjes, nuk reflekton rritje apo përmirësim krahasuar.

Ndërkohë, treguesi “Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme dhe të ulët)” ka pësuar rritje të lehtë duke krahasuar pozicionet drejtuese në total duke reflektuar përmirësim të grave në pozicione menaxheriale dhe administrative nga 50% në 52.27%. Nga ana tjetër, aspekti cilësor që lidhet me “Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore” tregon se bashkia nuk ka hartuar ende një plan të tillë, gjë që kufizon mundësinë për një qasje të koordinuar dhe afatgjatë ndaj politikave të barazisë gjinore. Mungesa e këtij dokumenti strategjik ndikon drejtpërdrejt në mungesën e mekanizmave të monitorimit dhe masave konkrete për përmirësim të balancës gjinore në vendimmarrje.

Në përmbledhje, viti 2025 paraqitet si periudhë e qëndrueshmërisë pa progres të ndjeshëm në drejtim të barazisë gjinore, duke theksuar domosdoshmërinë për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore dhe për krijimin e mekanizmave të qartë institucionalë për promovimin e grave në pozicione drejtuese. Kjo do të siguronte një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të balancuar në proceset e qeverisjes vendore.

Tabela 20: Të dhënat e detajuara për barazinë gjinore

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	29.73	29.73	0.00	→	0.00%
Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	50.00	52.27	2.27	↑	4.55%

Tabela 21: Të dhënat në burim për barazinë gjinore

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D81	Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	37	37	37	Numër
D82	Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	11	11	11	Numër
D83	Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	40	40	44	Numër
D84	Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	15	20	23	Numër
D85	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0).

7.3. BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit, përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Analiza e treguesve të burimeve njerëzore tregon një dinamikë të vazhdueshme në menaxhimin e stafit të Bashkisë gjatë vitit 2025. Numri total i punonjësve në bashki ka shënuar rritje të qëndrueshme nga 522 punonjës në vitin 2023, në 587 në vitin 2024 dhe 607 punonjës në vitin 2025, duke reflektuar zgjerimin e kapaciteteve administrative dhe nevojën për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike. Gjatë vitit 2025 janë larguar nga puna 22 punonjës, krahasuar me 7 largime në vitin 2024, kjo për faktin se gjatë vitit një pjesë e tyre kanë mbyllur marrëdhëniet me punën pasi kanë dalë në pension. Një zhvillim pozitiv konstatohet në fushën e ngritjes profesionale të stafit. Numri i punonjësve të trajnuar është rritur ndjeshëm nga 20 punonjës në vitin 2024 në 49 punonjës gjatë vitit 2025. Kjo rritje tregon angazhimin e institucionit për forcimin e aftësive profesionale dhe përmirësimin e performancës së administratës vendore. Sa i përket përdorimit të shërbimeve të nënkontraktuara, gjatë vitit 2025 rezultojnë 9 punonjës të angazhuar nëpërmjet kontraktimit të shërbimeve, krahasuar me mungesën e tyre në vitin 2024. Ky tregues evidenton përdorimin e mekanizmave alternativë për përmbushjen e nevojave specifike operacionale të bashkisë. Në raport me popullsinë e përgjithshme të bashkisë, e cila ka shënuar një rritje të lehtë nga 75,339 banorë në vitin 2023 në 75,696 banorë në vitin 2025, numri i punonjësve të administratës ka ardhur në rritje, duke ndikuar pozitivisht në raportin staf-popullsi dhe potencialisht në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët.

Në tërësi, të dhënat tregojnë një forcim të kapaciteteve njerëzore të institucionit, rritje të investimit në zhvillimin profesional të stafit dhe një përpjekje për përshtatjen e strukturave administrative me nevojat në rritje të komunitetit. Niveli i largimeve për shkak të arritjes së moshës së pensionit, por jo vetëm, kërkon monitorim të vazhdueshëm në mënyrë që të sigurohet stabilitet dhe efektivitet në administratë.

Tabela 22: Të dhënat në burim për burimet njerëzore

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D73	Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	522	587	607	Numër
D74	Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	16	7	22	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	75339	75582	75696	Numër
D75	Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	20	20	49	Numër
D76	Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	68	0	9	Numër

7.4. INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, edhe qeverisjen vendore. Bashkitë luajnë një rol kritik në përafrimin me *acquiscommunautaire* dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Adoptimi i ndryshimeve ligjore në proceset e punës së bashkive, që vijnë si pasojë e procesit të integritimit të Shqipërisë në BE

Gjatë periudhës së raportimit për vitin 2025, mbetet sfida numri i projekteve të fituara e cila rrit mundësinë për të siguruar më shumë financime nga donatorët e huaj. Por shihet e përmirësuar treguesi mbi numrin e aplikimeve për projekte në programet e BE ku për vitin 2025 kemi një rritje të lehtë të tyre.

Nga ana tjetër, treguesi “Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki” ka mbetur i pandryshuar duke reflektuar një mungesë të bashkëpunimeve horizontale ndërmjet njësisive vendore, të cilat mund të luanin një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e praktikave të mira dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta. Në aspektin institucional, Plani i Migracionit dhe Diasporës rezulton ende i pahartuar. Kjo tregon se bashkia nuk ka ndërmarrë ende hapa konkretë për hartimin e një dokumenti strategjik që do të mundësonte angazhimin më të mirë të diasporës në zhvillimin lokal dhe ruajtjen e lidhjeve të qëndrueshme me komunitetet emigrante.

Një zhvillim pozitiv është vërejtur në treguesin cilësor për Komisionet e Integritit Evropian pranë këshillave bashkiakë, të cilat janë ngritur gjatë vitit 2024, duke forcuar infrastrukturën institucionale të bashkisë në procesin e përafrimit me standardet evropiane. Krijimi i këtyre komisioneve shënon një hap të rëndësishëm drejt përfshirjes së përfaqësuesve vendorë në monitorimin dhe koordinimin e çështjeve që lidhen me politikën e BE-së. Po ashtu shihet progres në numrin e aplikimeve për projekt-propozime nga viti 2024 në vitin 2025, edhe pse mbetet sfidues përfitimi i granteve. Në përmbledhje, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se bashkia mbetet ende prapa në nënshkrimin e marrëveshjeve bashkëpunuese dhe miratimin e planeve strategjike për migracionin dhe diasporën. Ky kombinim tregon një rritje graduale të kapaciteteve institucionale, por edhe hapësirë të gjerë për përmirësim në dimensionin e bashkëpunimit ndërvendor dhe planifikimit afatgjatë.

Tabela 23: Të dhënat e detajuara për koordinimin e integritit evropian

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Tren di	Simbol	% Ndryshimi
Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%
Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	100.00	0.00	-100.00	↓	-100.00%
Komisionet e integritit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%

Tabela 24: Të dhënat në burim për koordinimin e integritit evropian

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D87	Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D88	Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	0	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D89	Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit	3	1	4	Numër
D90	Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit	1	1	0	Numër
D92	Komisionet e Integritit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	0	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)

7.5. MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxhetimi. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizën e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Analiza e performancës për vitin 2025 është strukturuar mbi tre shtylla kryesore: realizimi i të ardhurave, optimizimi i shpenzimeve dhe efikasiteti i buxhetimit.

1. Analiza e të Ardhurave Vendore dhe Ecuria Fiskale

Gjatë vitit 2025, treguesit e të ardhurave të veta vendore kanë pësuar një korrektim strukturor të pritshëm. Të ardhurat e veta për frymë u stabilizuan në vlerën 1,691.15 lekë/person nga 3,825.04 lekë që ishin në vitin paraardhës (një ndryshim prej -55.79%), gjë që ka reflektuar edhe në rënie e peshës së të ardhurave të veta ndaj buxhetit total (13.68%). Po ashtu, të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme shënuan një rënie prej -44.24% në raport me të ardhurat totale vendore.

Ky trend nuk dëshmon rënie të kapacitetit mbledhës apo dobësi në administrimin fiskal të bashkisë, por vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e përmbushjes së objektivave të aksionit të jashtëzakonshëm të ndërmarrë nga bashkia në vitet paraardhëse (veçanërisht gjatë vitit 2024, ku të ardhurat faktike arritën pikun prej 289,104 mijë lekësh). Ky aksion u fokusua në mbledhjen intensive të detyrimeve të prapambetura dhe debiteve historike të bizneseve dhe familjarëve. Pasi u arkëtuan me sukses këto detyrime të prapambetura, baza e të ardhurave për vitin 2025 u rikthye në nivelin e saj të natyrshëm të vitit korrent, pasi tashmë nuk ka më detyrime të prapambetura masive për t'u mbledhur. Ky fakt konfirmohet plotësisht nga treguesi i uljes drastike me -80.91% të stokut të detyrimeve financiare të papaguara (nga 42,625 mijë lekë në vitin 2024 në vetëm 9,423 mijë lekë në vitin 2025), çka dëshmon për një disiplinë të lartë financiare dhe pastrim të suksesshëm të bilanceve bashkiake.

Nga ana tjetër, shkalla e përdorimit të të ardhurave ka shënuar rritje pozitive (+8.15%), duke arritur në 89.43%, çka reflekton një përdorim më efektiv dhe më të shpejtë të likuiditeteve të disponueshme në arkën e bashkisë për shërbime ndaj komunitetit.

2. Shpenzimet Buxhetore dhe Shpërndarja Burimore

Në krahun e shpenzimeve, viti 2025 dëshmon një performancë të shkëlqyer në drejtim të planifikimit dhe disiplinës buxhetore. Bashkia ka arritur një shkallë ekzekutimi të buxhetit në masën 100% (836,703 mijë lekë të shpenzuara kundrejt 836,703 mijë lekë plan i rishikuar), duke shënuar një rritje të efikasitetit të ekzekutimit prej +22.64% krahasuar me vitin e kaluar (ku realizimi ishte 81.54%). Ky realizim maksimal tregon rritje të kapaciteteve menaxhuese të drejtorive zbatuese.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve:

- Shpenzimet e personelit janë rritur, çka ka ardhur kryesisht si pasojë e politikave kombëtare të rritjes së pagave në administratën publike dhe reformave strukturore për mbajtjen e stafit të kualifikuar në nivel vendor.
- Shpenzimet operacionale dhe mirëmbajtja janë menaxhuar në mënyrë të kursyer, duke pësuar një rënie prej -6.96% në peshën e tyre buxhetore (duke zbritur në 28.05%), gjë që reflekton masa për racionalizimin e kostove administrative.
- Shpenzimet kapitale (Investimet) për vitin 2025 u realizuan në vlerën 68,661 mijë lekë, duke shënuar një rënie të investimeve për frymë (-28.34%) dhe të peshës së tyre në buxhet (8.21%). Kjo tkurrje e përkohshme e orientimit drejt projekteve të reja kapitale ka ardhur si pasojë e alokimit të fondeve me prioritet drejt likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura të trashëguara, me synim garantimin e një fillimi të shëndetshëm dhe pa borxhe për ciklin e ardhshëm të investimeve të bashkisë.

Pasqyra financiare e Vitit 2025 dëshmon se Bashkia ka hyrë në një fazë të maturisë dhe stabilitetit fiskal. Eliminimi pothuajse tërësor i stokut të detyrimeve (-80.91%) dhe realizimi 100% i buxhetit janë arritje institucionale që ndërtojnë baza të qëndrueshme për vitet e tjera financiare.

Tabela 25: Të dhënat e detajuara për menaxhimin financiar

Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi
Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	3825.04	1691.15	-2133.89	↓	-55.79%
Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	49.43	15.85	-33.58	↓	-67.93%
Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	33.08	13.68	-19.40	↓	-58.64%
Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	82.69	89.43	6.74	↑	8.15%
Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	14.35	8.00	-6.35	↓	-44.24%
Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	11726.20	11053.46	-672.74	↓	-5.74%
Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	81.54	100.00	18.46	↑	22.64%
Investime për frymë	leke/person	1265.71	907.06	-358.65	↓	-28.34%
Pesha e investimeve në buxhet	%	13.24	8.21	-5.03	↓	-38.01%

Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	5.90	1.13	-4.77	↑	- 80.91%
Pesha e personelit në buxhet	%	56.61	63.74	7.13	↑	12.59%
Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	30.15	28.05	-2.10	↓	-6.96%

Tabela 26: Të dhënat në burim për menaxhimin financiar

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D93	Të ardhurat e veta, fakt	220834	289104	128013	Mijë Leke
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	75339	75582	75696	Numër
D94	Transfertat gjithsej, fakt	385377	584820	807573	Mijë Leke
D95	Të ardhurat e përgjithshme, fakt	606211	873924	935586	Mijë Leke
D96	Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	594653	722658	836703	Mijë Leke
D97	Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	7494	41496	10246	Mijë Leke
D98	Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	743814	886290	836703	Mijë Leke
D99	Shpenzime kapitale, fakt	76424	95665	68661	Mijë Leke
D100	Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	55981	42625	9423	Mijë Leke
D101	Shpenzime personeli, fakt	330376	409129	533356	Mijë Leke
D102	Shpenzime operacionale, fakt	187853	217864	234686	Mijë Leke

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

8.1. KONKLUZIONE

- Raporti i Performancës 2025, mbi bazën e të dhënave 2024–2025 nga Sistemi i Matjes së Performancës, tregon se Bashkia Kurbin po konsolidon gradualisht një profil më të qëndrueshëm në ofrimin e shërbimeve publike dhe në qeverisjen e mirë, megjithëse mbeten fusha ku nevojiten hapa më të qartë strategjikë. Në tërësi, vërehet një kombinim midis stabilitetit në shërbimet bazë, përmirësimeve të dukshme në disa sektorë kyç (si financat, shërbimet sociale, mbrojtja nga zjarri, ujëtja/kullimi) dhe boshllëqeve në planifikim afatgjatë (sidomos në plane sektoriale dhe barazinë gjinore).
- Në fushën e **arsimit parauniversitar**, bashkia ka shënuar përmirësim në aspektin e infrastrukturës në tërësi të institucioneve arsimore, pasi një pjesë e mirë e tyre janë të rindërtuar dhe të rikonstruara. Gjithashtu kemi rritje të numrit të fëmijevë të regjistruar në çerdhe dhe përmirësim të kapaciteteve të stafit. Gjithashtu për vitin 2025 është rritur ndjeshëm edhe stafi mbështetës në arsimin bazë dhe të mesëm, si dhe zhvillimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar tregon përmirësim të dukshëm në aspektin e planifikimit strategjik dhe menaxhimit të sektorit.
- Sa i përket **menaxhimit të mbetjeve**, mbulimi i popullsisë me shërbim është i qëndrueshëm, tarifatat mbulojnë një pjesë gjithnjë e më të madhe të kostos dhe ekziston një Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve në fuqi. Kjo tregon bazë të mirë organizative dhe financiare, si dhe përmirësim të shërbimit dhe ulje e ndotjes.
- Në **mbrojtjen nga zjarri**, kapacitetet njerëzore dhe numri i mjeteve ka mbetur i qëndrueshëm. Kjo reflekton një shërbim funksional të njëjtë me vitin e mëparshëm, por kërkohen investime shtesë në modernizimin e flotës dhe pajisjeve, si dhe në komponentin parandalues.
- **Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**, rezultatet tregojnë një progres të qëndrueshëm në menaxhimin dhe efikasitetin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, që lidhet me ndërhyrje të qëllimshme të bashkisë në pastrimin e kanaleve, riparimin e segmenteve të dëmtuara dhe mirëmbajtjen periodike të infrastrukturës ekzistuese.
- Në **administrimin e pyjeve dhe kullotave**, situata e funksionimit të këtij sektori mbetet e njëjtë si në aspektin e zhvillimit të dokumentit strategjik i cili ende mungon, po ashtu edhe në aspektin e kapaciteteve operative për mbikëqyrje dhe menaxhim në terren ku numri i punonjësve nuk ka ndryshuar.
- **Mbrojtja sociale** paraqet disa arritje të rëndësishme: rritje shumë të madhe të shkallës së miratimit të strehimit social, zgjerim të numrit të qendrave sociale komunitare dhe rritje të përqindjes së rasteve të referuara nga MKR që përfitojnë shërbime (deri në 100%). Plani Vendor Social është në fuqi dhe kjo tregon stabilitet strategjik.
- Sa i përket **transparencës**, raporti vjetor mbetet i publikuar dhe i qëndrueshëm, si dhe këtë vit është përmirësuar treguesi mbi hartimin e Planit të Integritetit si një dokument bazë i rëndësishëm e cila përcakton rregullat mbi parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e integritetit e parimeve institucionale.
- Në **barazinë gjinore**, përfaqësimi i grave në pozicionet kryesore politike-administrative është stabil. Në disa tregues ka ulje, ndërsa Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore ende nuk është hartuar. Kjo tregon se mungon një qasje e strukturuar për avancimin e barazisë gjinore përtej niveleve aktuale.

- Në **integrimin në BE**, bashkia ka bërë përparim të ndjeshëm në numrin e projekteve të aplikuara dhe ngritjen e komisionit të integritit pranë këshillit bashkiak. Megjithatë, vazhdojnë të mungojnë marrëveshjet ndërbashkiake dhe planet e migracionit/diasporës, që mund të rrisnin bashkëpunimin dhe shfrytëzimin e potencialit të diasporës.
- Tek **menaxhimi financiar** kemi rënie të të ardhurave për frymë, kemi rënie të të ardhurave të veta edhe pse menaxhimi i tyre paraqitet pozitiv dhe eficient. Po ashtu kemi një menaxhim më të mirë të detyrimeve dhe ekzekutimit të buxhetit.
- Së fundmi, **administrimi i tregjeve** në vitin 2025 karakterizohet nga rezultate deri diku të qëndrueshme. Për të përmirësuar performancën, kërkohet fokus në rritjen e investimeve, përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe nxitjen e aktiviteteve që gjallërojnë jetën ekonomike të tregjeve.

8.2. REKOMANDIME

- Të hartohet dhe miratohet Plani Vendor për Mbarështimin e Pyjeve dhe Kullotave, për të garantuar menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Të hartohet dhe miratohet Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve pasi plani aktual është i vlefshëm deri në fund të vitit të raportimit.
- Të forcohen kapacitetet financiare të vetë bashkisë, duke rritur performancën e të ardhurave në raport me transfertat në mënyrë që të krijohet një sistem më i qëndrueshëm dhe autonom sa i përket financave vendore.
- Të forcohen kapacitetet profesionale të administratës përmes programeve të rregullta dhe të synuara trajnimi.
- Të hartohet Plani Vendor i Veprimtimit për Barazinë Gjinore, si instrument për orientimin dhe monitorimin e politikave gjinore si dhe të ndërmerren politika të posaçme për nxitjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese.
- Të investohet në përmirësimin e kapaciteteve operacionale në fushën e mbrojtjes nga zjarri për të patur një shërbim më eficient në rastet emergjente.
- Të rritet numri i aplikimeve për projektet e BE-së përmes forcimit të kapaciteteve teknike dhe koordinimit ndërsektorial.
- Të intensifikohet bashkëpunimi ndërbashkiak përmes nënshkrimit të marrëveshjeve strategjike në fusha me interes të përbashkët.
- Të hartohet dhe miratohet Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, për të strukturuar angazhimin e diasporës në zhvillimin lokal.
- Të përmirësohet infrastruktura e tregjeve publike.
- Drejtoritë të angazhohen për përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe analizës së të dhënave.